




KAMPUSI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS, HAPËSIRË PUBLIKE E SIGURTË DHE E PËRSHTATSHME PËR TË GJITHË

Prishtinë
Qershor 2018



Punëtorja "Kampusi i UP-së hapësirë publike e sigurtë dhe e përshtatshme për të gjithë" aktivitet i realizuar në kuadër të projektit "Qytetet Gjithëpërfshirëse" - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" i përkrahur financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë. Përmbajtja është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e donatorit.



"Qytetet Gjithëpërfshirëse- promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" është projekt i ECI cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje dhe fshatra të ndryshme të komunës.

Botues: EC Ma Ndryshe

Autor: Rron Beqiri, arkitekt dhe Gentiana Pallaska, arkitekte

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
029-222-771 & 038-224-967



02 Hyrje

05 Qëllimi

07 Metodologjia

11 Gjendja Ekzistuese
Sipërfaqet
Funksioni dhe ndriçimi
Qarkullimi
Matjet

'Space Syntax' Analiza
Problemet dhe potencialet

29 Propozimi / Rekomandimet
Masterplani
Vizualizimet

HYRJE

Rreth 45,000 është numri i studentëve vetëm në Universitetin e Prishtinës 'Hasan Prishtina'.¹ Mirëpo kampusi përveç që shfrytëzohet prej studenteve të UP-së, shfrytëzohet edhe prej një pjese të madhe të qytetareve tjerë, aktiviteti i të cilëve jo domosdoshmërisht lidhet me universitetin. Ky fakt ia shton kampusit edhe barrën e akomodimit të aktiviteteve tjera përveç atyre që i nevojiten vetëm studentëve.

Kampusi i UP-së ka pozitë shumë të mirë në raport me qytetin, gjë që e bën atë të ketë potencial tejet të madh për zhvillim dhe shfrytëzim. Megjithatë kampusi i UP-së ka probleme serioze bazike si mungesa e aktiviteteve, identitetit, infrastrukturës bazike, qasje për persona me aftësi të kufizuara, etj. Problem po aq serioz për kampusin mbetet edhe çështja e pronësisë jo vetëm me Kishën Ortodokse Serbe, por edhe me vetë institutet brenda për brenda kampusit, gjë që e bën të vështirë çfarëdo intervenimi afatgjatë.


Si problem më emergjent është edhe siguria në hapësirën e kampusit si pasojë e mungesës së ndriçimit, kamerave të sigurimit, por edhe mungesës së aktiviteteve që do të mund të rritnin sigurinë në përgjithësi.

Shumë prej problemeve në kampusin e UP-së si mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra, mirëmbajtja e mobiluarit dhe elementeve sinjalizuese, pastërtia, organizimi i aktiviteteve etj., kanë kryesisht zgjidhje të natyrës menaxheriale.

Për t'i identifikuar problemet dhe potencialet e hapësirës së kampusit të UP-së është organizuar një punëtori me pjesëmarrës të ndryshëm të komunitetit.

Prej punëtorisë dhe hulumtimit, del se kampusi përdoret kryesisht si hapësirë tranzit nga qytetarët si dhe mungon lidhja në mes të funksioneve të ndërtesave brenda kampusit.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Statistikat e Arsimit 2014 - 2015. Kosovë, 2015, fq. 55



Hapësira e kampusit të Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina'

QËLLIMI

Identifikimi dhe njohja me problemet dhe potencialit e një hapësire nuk është proces i lehtë. Metodë që është treguar e suksesshme në identifikimin e problemeve dhe potencialit të një hapësire është involvimi i komunitetit në proces nga fillimi deri në fund.

Kjo metodë varet nga qasja pjesëmarrëse e zhvillimit të komunitetit që shpesh shoqërohet me punën sociale të bazuar në komunitet, e gjithashtu shpesh përdoret nga organizatat e komunitetit.

Nga kjo qasje, projektuesit, urbanistët dhe arkitektët vlerësojnë nevojat dhe potencialet ekzistuese brenda një komuniteti, dhe, duke përfshirë pjesëtarët e komunitetit në proces, përpiqen të krijojnë një zgjidhje të qëndrueshme dhe të barabartë në adresimin e nevojave të komunitetit.

Qëllimi i punëtorisë

Punëtorja "Kampusi i UP-së hapësirë publike e sigurtë dhe e përshtatshme për të gjithë" aktivitet i mbajtur në kuadër të projektit "Qytetet Gjithëpërfshirëse - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" përkrahët financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahët nga Qeveria e Suedisë.

Kjo punëtori ka për qëllim shqyrtimin e sfidave më të rëndësishme me të cilat ballafaqohen grupet e nënpërfaqësura të qytetit dhe vizionimin e tyre sipas metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje. Gjatë kësaj punëtorie është trajtuar hapësira e kampusit të UP-së ku pjesëmarrësve iu është ofruar mundësia të shprehin vizionin e tyre për këtë hapësirë.

"Qytetet Gjithëpërfshirëse - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje" është projekt i EC, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje dhe fshatra të ndryshme të komunës.

METODOLOGJIA

Zhvillimi i punëtorisë është bërë në mënyrë që të ketë diskutim të hapur rreth eksperiencës së pjesëtarëve në hapësirën e kampusit. Realizimi i punëtorisë është zhvilluar duke i përcjellur tri faza kyçe me disa nënfaza që shpjegohen në vijim.

Faza e parë, "*Identifiko*", i inkurajon pjesëmarrësit që duke i shfrytëzuar hartat apo ortofoton e zonës së kampusit të identifikojnë problemet dhe potencialet.

Faza e dytë, "*Shprehu*", i inkurajon pjesëmarrësit të diskutojnë lidhur me problemet dhe kërkesat e tyre të ndërlidhura me kampusin e UP-së.

Faza e fundit, "*Vizualizo*", stimulon pjesëmarrësit që përmes mjeteve të punës, si letër për skicim, kartonë, ngjyra etj. të vizualizojnë skematikisht propozimet e dalura nga faza "*Shprehu*".



Fotografi nga punëtorja



01.
Takimi me komunitetin

Punëtorja me pjesëmarrës të komunitetit, e organizuar nga EC, me qëllim që të diskutohen sfidat dhe potencialet e hapësirës së kampusit të UP-së.



02.
Diskutimi i problemeve dhe potencialeve

Në këtë fazë bëhet diskutimi dhe pastaj skicimi dhe paraqitja e problemeve dhe potencialeve, si dhe çdo gjë që mendohet të ndryshohet.



03.
Hulumtimi dhe analiza në terren

Në vijim janë bërë matje dhe analiza në hapësirën e kampusit në mënyrë që të kuptohet më mirë aspekti fizik dhe social i hapësirës.



04.
Punimi i draft propozimit

Propozimi fillestar i cili tenton më së miri të përfshijë kërkesat që kanë dalur si rezultat i punëtorisë.



05.
Diskutimi i draft propozimit

Draft propozimi iu tregohet pjesëmarrësve të punëtorisë dhe përfaqësuesve tjerë që në një mënyrë ose tjetrën do të ndikohen nga ndërhyrjet potenciale.



06.
Propozimi final

Propozimi i cili përfshin të gjitha kërkesat e nevojat e vendit, përfill të gjitha potencialet dhe anët pozitive, si dhe kritikën e të gjitha palëve.

Përveç punëtorisë me pjesëmarrës të komunitetit, për t'i shtuar vlerë procesit në përgjithësi, është bërë edhe hulumtimi dhe analiza e lokacionit duke bërë ecje dhe intervista me njerëz.

Gjithashtu është bërë matja e qarkullimit të njerëzve si dhe përcjellja e lëvizjes së përdoruesve të hapësirës, metodë e cila na

dhuron një pasqyrë të mirë se kush është përdoruesi i hapësirës së kampusit dhe në ç'mënyrë e përdorin ata këtë hapësirë.

Si aspekt analitik vizual është bërë edhe dokumentimi fotografik i problemeve dhe potencialeve që gjenden brenda hapësirës së kampusit.



Fotografi nga punëtorja



Fotografi nga punëtorja



ÇKA ËSHTE KAMPUSI?

KAMPUS, emër, shumës: **kampuse**
/at, një hapësirë e sheshtë e tokës, fushë,
fushë/.

1. Kolegj ose universitet
2. Sipërfaqja e tokës që zakonisht përmban ndërtesat universitare, të kolegjit, ose të shkollës
3. Sfera e edukimit të lartë

Kampusi është sipërfaqja dhe hapësira në të cilën gjendet një kolegj ose universitet së bashku me ndërtesat institucionale përcjellëse.

Zakonisht një kampus universitar përmban bibliotekat, sallat e ligjeratave, sallat e mësimi, qendrat e studentëve apo sallat e ngrënies, parkun si dhe mjedise të ndryshme përcjellëse me strehim të studentëve, objekte mësimore dhe kërkimore, si dhe aktivitete të kohës së lirë të gjitha së bashku.

GJENDJA EKZISTUESE

Rezultatet e dala nga punësia tregojnë një llojllojshmëri të problemeve por edhe hapësirë të madhe për përmirësim të kampusit në përgjithësi. Si ankesë kryesore nga qytetarët, por dhe problem kryesor që është shtruar nga pjesëmarrësit në punëtori, është siguria në kampus si shkak i mungesës së ndriçimit dhe aktiviteteve.

Potenciali i Bibliotekës Kombëtare nuk shfrytëzohet në maksimum për shkak se shumica e hapësirës përreth nuk përdoret për ndonjë aktivitet tjetër përveç si rrugë tranzit ose me raste edhe si hapësirë për pushim të shkurtër nga studentët, stafi i universitetit dhe kalimtarët tjerë. Pozita e bibliotekës si qendër e kampusit mund të shfrytëzohet për të gjallëruar gjithë kampusin duke qenë se funksioni kryesor i bibliotekës së bashku me funksionet përcjellëse të saj duhet të shtrihet edhe jashtë mureve të ndërtesës.

Fakti që kampusi ka sipërfaqe të mëdha të gjelbërimit është mundësi e mirë për të pasur aktivitete gjatë tërë kohës nga përdorues dhe kalimtarë të ndryshëm dhe intervenime të përkohshme që nuk janë të kushtueshme dhe i ofrojnë hapësirës multi-funksionalitetin që e meriton.

Qështje tjetër tejet e rëndësishme që del nga intervistat dhe hulumtimi në terren është se qasjet dhe shtigjet janë të dëmtuara në masë të konsiderueshme, pjesë të cilat shndërrohen në barriera fizike. Kjo gjendje e dyshemesë së hapësirës, mes tjerash, paraqet problem për qasjen e personave me aftësi të kufizuara në kampus, që vetëm sa i shtohet problemit të qasjes nëpër ndërtesat e kampusit, me përjashtim të objektit të Fakultetit të Edukimit.

Mangësi tjetër e hapësirës është vërejtur edhe mungesa e identitetit të kampusit të Universitetit të Prishtinës. Ky identitet ka mundësi të theksohet duke shtuar elemente të mobiliarit urban, por edhe me anë të gjelbërimit dhe aktiviteteve që mund të organizohen në këtë hapësirë.

Për më tepër, vazhdimi i Bulevardit 'Nëna Terezë' deri te Katedralja Nëna Terezë, së bashku me parkun e ri përmbi parkingun nëntokësor i cili do të ndërtohet përballë Fakultetit Filologjik, kanë potencial të madh në rritjen e trafikut këmbësor të kampusit nga ana perëndimore. Ky ndryshim do të rrisë kërkesën për përmirësimin e të gjithë hapësirës me elemente dhe aktivitete të reja.

Problemet



NDRIÇIMI

Ndjenja e sigurisë është e ulët për shkak të mungesës së ndriçimit dhe prishjeve të shpeshta të trupave ndriçues për shkak të lartësisë dhe kualitetit të tyre.



SHTIGJET E DËMTUARA

Nëpër të gjithë hapësirën e kampusit, shtigjet ekzistuese dhe pllakosja rreth bibliotekës janë të dëmtuara, gjë që shndërrohet në barrierë fizike për kalimtarët.



MUNGESA E AKTIVITETEVE

Hapësira e madhe e pashfrytëzuar, pa mobililar urban dhe pa aktivitete nuk i fton përdoruesit të bashkëveprojnë me ambientin rreth tyre, që rezultojnë me përdorim minimal të hapësirës nga ata.



QENTË ENDACAKË

Vërehet prezenca e qenëve endacakë në shumë nga hapësirat e kampusit që japin ndjenjë të pasigurisë që japin, sidomos në dimër si dhe nuk trajtohen mirë nga kalimtarët.



ZHURMA DHE TYMI

Duke qenë se kampusi ka rrugë kryesore të qytetit në tri anë, të cilat kanë qarkullim të madh të automjeteve, zhurma dhe tymi pengojnë zhvillimin e aktiviteteve.



PRONËSIA

Çështja e pronësisë brenda kufinjëve të kampusit nuk lejon trajtimin e tërë sipërfaqes duke kufizuar edhe llojet e intervenimeve në vetëm intervenime të përkohshme dhe të lëvizshme.



SINJALIZIMI

Domosdoshmëri e një kampusi janë shenjat afër shtigjeve që tregojnë vendndodhjen, ku gjenden ndërtesat e ndryshme, dhe janë udhëzues për përdoruesin nëpër hapësirë.



MOBILIARI URBAN

Duke shtuar mobililarin urban permanent dhe të përkohshëm në bashkëpunim me fakultetet përreth, kalimtarët kalojnë më shumë kohë aty dhe ndihmon në krijimin e ndjenjës së vendit dhe përkatësisë.



IDENTITETI

Sipas kalimtarëve dhe përdoruesve të hapësirës, kampusi i mungon identiteti si i tillë, duke e bërë këtë zonë të mos e ketë rëndësinë që e meriton.



HAPËSIRA TË PAPËRDORURA

Përdhësa e bibliotekës përgjatë gjithë perimetrit të saj nuk shfrytëzohet, gjë që krijon përdhësë joaktive dhe jo-bashkëpunuese me ambientin dhe funksionet përreth.



AKTIVIZIMI I PËRDHESËS SË BIBLIOTEKËS

Shfrytëzimi i përdhësës së bibliotekës për lexim, mësim dhe pushim në ambient të jashtëm do të shtonte funksionet dhe kapacitetin e vetë ndërtesës.



FUSHAT E SPORTIT

Aspekt me rëndësi është shtimi i fushave apo tavolinave të ndryshme të sportit për të promovuar aktivitetin fizik.

Potencialet



NDRIÇIMI I LARTË

Ndriçimi më i lartë se ai ekzistues do të ishte parandalesë ndaj prishjes së qëllimshme të tyre, dhe rritja e kualitetit të trupave ndriçues siguron jetëgjatësinë e tyre.



SIGURIA

Kamerat e sigurisë të vendosura në pika strategjike nëpër të gjithë zonën jep ndjenjë më të madhe të sigurisë kundër krimeve të mundshme.



ÇIKLIZËM DHE VRAPIM

Prezenca e biçikletave dhe shtigjeve të destinuara për to si dhe për vrapim do të rezultonte në edhe më shumë përdorues duke krijuar mundësi që mbështesin aktivitetin fizik të përditshëm.



PARK PËR QENTË

Hapësira e dedikuar për qentë dhe lojërat e tyre do të mundësonte familjarizimin në mes të qenëve dhe kalimtarëve, si dhe si park ku njerëzit shkojnë me kafshët e tyre.

Sipërfaqet

Kampusi i Universitetit të Prishtinës ka sipërfaqe të mjaftueshme për të akomoduar të gjitha funksionet që i nevojiten dhe do t'i nevojiteshin në të ardhmen.


Sipërfaqet e gjelbra e dominojnë hapësirën e kampusit, ndonëse nuk janë të menduara dhe të shtrira në mënyrën më të mirë.

Në kampus, përveç shtigjeve formale, ekzistojnë edhe një numër i madh i shtigjeve jo formale, apo shtigjeve që janë krijuar nga


njerëzit që kalojnë nëpër këtë hapësirë. Këto shtigje 'joformale' duhet të shtrohen me pllakëza në mënyrë që të funksionalizohen edhe në kohë kur moti nuk është i mirë.

80% e sipërfaqeve të kampusit përbëhen nga gjelbërimi dhe shtigjet për ecje, ndërsa vetëm 19% e sipërfaqes së kampusit është e ndërtuar. Kjo do të thotë se kampusi i UP-së ka kapacitet që të shndërrojë edhe rreth 10% të hapësirës së gjelbër në hapësirë të ndërtuar pa cenuar kualitetin e vendit.

Sipërfaqet e gjelbra



Sipërfaqet e shtigjeve



Sipërfaqet e ndërtuara




Funkzioni dhe Ndriçimi


Kampusi i Universitetit të Prishtinës ka një përzierje mjaft të mirë të funksioneve të ndërtesave, gjë që i shton vlerë hapësirës për shkak të natyrës së ndryshme të përdoruesve. Problem mbetet Kisha Ortodokse Serbe, e cila nuk ka kurrfarë funksioni, dhe është vështirë të adaptohet apo t'i ndërrohet funksioni në diçka që me të vërtetë i nevojitet kampusit.

Fatkeqësisht hapësira e kampusit është pothuajse tërësisht e pa ndriçuar, me përjashtim të ndriçimit të ndërtesave. Ky është faktori kryesor që e bën këtë hapësirë të pa sigurtë për shfrytëzim dhe për të kaluar aty gjatë natës.


Funksionet e ndërtesave



Zonat e aktiviteteve



Ndriçimi artificial



Qarkullimi

Për të kuptuar trendet e lëvizjeve të qytetarëve, si dhe volumin e prezencës së tyre, është bërë matja dhe përcjellja e tyre nëpër disa pika të hapësirës së kampusit të UP-së.


Siç është cekur, hapësira e kampusit përdoret kryesisht si tranzit nga qytetarët, sidomos për kalimin nga rruga Agim Ramadani, në rrugën Xhorxh Bush.

Pjesa më e frekuentuar nga ata është

rruga pranë Fakultetit Ekonomik, që lidh rrugën Agim Ramadani me bulevardin 'Nëna Terezë'. Kjo është edhe për faktin se fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Juridik janë ndër fakultetet me numrin më të madh të studentëve nga i gjithë universiteti.


Fakti se kampusi ka qarkullim të madh të studentëve tregon për potencialin që ka kjo hapësirë. Megjithatë sfida mbetet ngadalësimi dhe ndalimi i këtyre kalimtarëve që të shfrytëzojnë hapësirën.

Lëvizjet



- ■ ■ Qarkullimi i madh
- Qarkullimi mesatar
- - - Qarkullimi i ulët

Shtigjet



- Shtigje formale
- - - Shtigje joformale



Shteg joformal për ecje në kampus



Shteg për ecje në kampus




Shteg për ecje në kampus


Matjet

Matjet e numrit të njerëzve janë bërë në ditë punë, nëpër pesë pika me rëndësi dhe qarkullim më të madh. Orët e përzgjedhura janë ato në të cilat qarkullimi i njerëzve rritet:


9:00 - dalja nëpër vende pune, 12:00 - koha e pauzës 16:30 - përfundimi i punës nëpër institucione publike. Matjet kanë zgjatur 10 minuta në secilin termin.




Biblioteka Kombëtare




Rektorati




Fakulteti i Ekonomisë



Galeria Kombëtare



Instituti Albanologjik





Panoramë e kampusit



Panoramë e kampusit



Panoramë e kampusit

'Space Syntax' Analiza


Potenciali gjeometrik i hapësirës është analizuar sipas metodologjisë 'Space Syntax'. Kjo metodologji përdorë grafet e ndërtuara mbi rrjetin urban në brendësi të hapësirës si bazë për të analizuar potencialin e përdorimit të asaj hapësire nga njeriu. Space Syntax bënë reprezentimin kuantitativ të hapësirës bazuar në të dhënat topografike të saj, pastaj vetitë për brenda hapësirës analizohen përmes grafeve topologjike.

Në rastin tonë të studimit janë përdorur hartat konvekse të cilat janë rezultat i studimit të hapësirave konvekse (hapësirat ku të gjitha 'segmentet' që bashkojnë pikat për të krijuar grafikun për analize, gjenden brenda vijës perimetrike të hapësirës përkatëse.) Objektet e 'forta' të palevizshme janë konsideruar si 'pengesa', kurse të gjitha hapësirat e ndërmjetme janë konsideruar si boshllëk.

Harta e Levizjes jep një psaqyrë të potencialit gjeometrik të hapësirës ekzistuese për të pasur levizje. Rezultatet e analizave tregojnë hapësirat që në aspektin morfologjik

perkrahin më shumë levizjen në krahasim me hapësirat tjera, konkretisht se cilat hapësira janë të arritshme me më pak ndryshime të drejtimit gjatë trajektorës së ecjes.


Sipërfaqet e hapura



Gafiku i vizuarave matë depertueshmerinë vizuale të hapësirës bazuar në afesitë e njeriut për të parë. Gafiku i vizuarave ka për element bazë 'isovistet', që paraqesin lidhjet

mes hapësirave që mund të shihen direkt (nyjet e vështrimit) nga pika e caktuar e vështrimit.


Lëvizjet



Konkretisht, grafiku konstruktohet nga mbishtresimet e të gjitha 'isovisteve' të cilat është e mundur të konstruktohen brenda hapësirës ku, pika e vështrimit dhe caku i vështrimit janë nyjet e grafikut ndërsa vija që i lidhë këto te dyja është 'lidhja' në grafik.

Përmes ngjyrave mund të vërejmë 'nyjet' nga të cilat konfiguracioni i hapësirës e bënë më lehtë lidhjen vizuale (kuqe), deri tej ato 'nyje' me më shumë pengesa apo depertueshmëri vizuale (kaltër).

Vizurat






Fig. 11 Ortofoto e kampusit të UP-së

Problemet dhe Potencialet

Në hartën në vijim janë paraqitur të gjitha problemet dhe potencialet e hapësirës së kampusit, që pjesëmarrësit në punëtori i

kanë përzgjedhur si më të rëndësishmet dhe më me nevojë për ndërhyrje.





PROPOZIMI DHE REKOMANDIMET

Duke u bazuar në kërkesat dhe idetë që kanë dalur nga punëtorja me pjesëmarrësit e komunitetit, por edhe nga hulumtimi në

terren, në vijim janë të paraqitura propozimet dhe rekomandimet për intervenime eventuale në hapësirën e kampusit të UP-së.

Ndriçimi dhe Kameran e Sigurisë

Mungesa e ndriçimit dhe kamerave të sigurisë ka qenë brenga kryesore e pjesëmarrësve në punëtori, por edhe e qytetarëve të intervistuar. Me ndriçim duhen të jenë të mbuluara, të paktën shtigjet kryesore që e prejnë sipërfaqen e kampusit.

Institucionet përkatëse, së bashku me ekspertë të lëmisë, duhet të bëjnë analiza për vendosjen e kamerave të sigurisë nëpër disa pika strategjike të kampusit.



Fig. 12 Kampusi gjatë natës



Fig. 13 Kampusi gjatë natës




Ndriçimi dhe shtigjet për vrapim dhe çiklizëm

Me një investim shumë të vogël mund të zgjidhen disa nga problemet kryesore që qytetarët i kanë adresuar. Ndriçimi i shtigjeve kryesore në kampus është i domosdoshëm, në mënyrë që të sigurohet kalimi nga cilido skaj i hapësirës në tjetrin. Në hartën në vijim

janë paraqitur numri minimal i shtigjeve që duhet të ndriçohen në mënyrë që kampusi të jetë i sigurtë.

Diagrami i shtigjeve





Pavilioni për hije

Kampusi i UP-së ka sipërfaqe të mëdha të cilat në të shumtën e rasteve nuk janë të mbojtura nga dielli, gjë që e bën të vështirë të përdoret hapësira gjatë ditëve me diell


të fortë. Më poshtë është paraqitur një shembull i një strukture të thjeshtë që do të ofronte hije nën të cilën do të mund të zhvilloheshin aktivitete të ndryshme.



Infopoint

Një nga problemet që ka dalur si rezultat i punëtorisë, është mungesa e sinjalizimit në brendi të kampusit. Shembulli i infopoint

që është paraqitur më poshtë, inkorporon sinjalizimin me hapësirë pune, ëireless internet dhe krua për pirje të ujit.



Amfiteatri në anën jugore të Bibliotekës Kombëtare. Ky amfiteatër mund të përdoret për shumë aktivitete të ndryshme si ligjerata, ceremoni të diplomimit, shfaqje të filmit apo edhe vetëm për qendrim.



An architectural rendering of a public plaza area. The scene features a large, multi-level stone staircase and several wooden planters with greenery. A man in a light blue shirt sits on a planter, while a woman in a grey sweater sits on the steps. A white silhouette of a person is shown walking across the plaza. In the background, a large building with a complex, geometric, and perforated facade is visible. A sign with a map is mounted on a wall. The overall atmosphere is modern and urban.

Përdhesa e Bibliotekës Kombëtare mund të aktivizohet, duke ofruar vende publike për ulje. Posaçërisht në ditë me diell, është hapësirë shumë e përshtatshme për pushim dhe freskim.



Hapësirë pranë Fakultetit të Artit, mund të shfrytëzohet për ekspozimin e punimeve të studentëve. Në këtë mënyrë do të ringjallej hapësira, por edhe studentët do të kenë ekspozim dhe vend ku të tregojnë punët.



Struktura 'Infopoint' që ofrojnë harta të kampusit, ëireless internet, hapësirë për mbushje të laptopëve/telefonëve, hapësirë për punë si dhe krrua për ujë të pijshëm.



Pavilioni i thjeshtë për hije në hapësirën në mes të Bibliotekës Kombëtare dhe Fakultetit të Arteve. Pjesa nën hije përveç qëndrimit mund të shfrytëzohet edhe për aktivitete tjera si yoga, lojë të fëmijëve, lexim, etj.



Shtigjet ekzistuese do të trajtohen që të ketë edhe vend për çiklistët dhe vrapuesit.



Shtigjet kryesore duhet të ndriqohen në mënyrë që të rritet siguria dhe atraktiviteti i hapësirës.



